



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

ZYRA E ADMINISTRIMIT TË PARKUT KOMBËTAR “LUMI I VJOSËS”

**SHPALLJE PËR 1 POZICIONE PUNE “ROJE MJEDISORE”, NË ZYRËN E  
ADMINISTRIMIT TË PARKUT KOMBËTAR “LUMI I VJOSËS”**

Në mbështetje të VKM-së nr.774, datë 13.12.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës” (ZAPK Vjosa), *institucion në nivel rajonal (Gjirokastrë), në varësi të ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura mjedisore*, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.19, datë 3.2.2025 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”, si dhe të Urdhrit të Drejtorit të ZAPK Vjosa “Për ngritjen e Komisionit Ad Hoc”, nr.14 , më datë 24.02.2026, shpallet pozicioni vakante i punës:

**1 (një) ROJE MJEDISORE NË ZYRËN E ADMINISTRIMIT TË PARKUT KOMBËTAR  
“LUMI I VJOSËS”**

**Afati për dorëzimin e dokumenteve 04/03/2026 pranë Zyrës së Administrimit të Parkut  
Kombëtar “Lumi i Vjosës”**

**Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

Detyra e rojes mjedisore kanë të bëjnë me zbatimin e politikave, rregulloreve dhe aktiviteteve që sigurojnë mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të parkut. Detyrat kryesore janë:

- **Mbrojtja dhe menaxhimi i biodiversitetit:** Zbatimi i masave për ruajtjen e faunës dhe florës, veçanërisht llojeve të rrezikuara, përmes mbrojtjes aktive dhe planifikimit të masave për restaurimin e habitateve të dëmtuara.
- **Zbatimi i rregullave dhe ligjeve të parkut:** Sigurimi i respektimit të rregullave për përdorimin e parkut, duke përfshirë parandalimin e aktiviteteve të paligjshme dhe menaxhimin e burimeve natyrore.
- **Koordinimi i aktiviteteve të turizmit të qëndrueshëm:** Menaxhimi i fluksit të vizitorëve dhe krijimi i mundësive për turizëm të qëndrueshëm, duke siguruar që aktivitetet turistike të mos ndikojnë negativisht në natyrë.
- **Promovimi i edukimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor:** Organizimi i aktiviteteve edukative dhe informuese për vizitorët dhe komunitetin lokal për rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe veprimet që ata mund të ndërmarrin për të kontribuar në mbrojtjen e parkut.
- **Koordinimi me autoritetet dhe organizatat e tjera:** Bashkëpunimi me institucionet qeveritare, OJQ-të dhe agjencitë mjedisore për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm dhe të integruar të parkut.

- **Garantimi i sigurisë dhe asistenca për vizitorët:** Garantimi i sigurisë së vizitorëve dhe ofrimi i informacionit të nevojshëm për t'u siguruar që ata ndjekin rregullat dhe kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit.

## KUSHTET PËR PRANIM DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kandidatët** duhet të plotësojnë kushtet për pranim si dhe kriteret e veçanta si vijon:

### **Kritere të përgjithshme**

- 1) Të kenë shtetësinë shqiptare;
- 2) Të jenë jo më pak se 18 vjeç;
- 3) Të gëzojnë zotësi të plotë për të vepruar;
- 4) Të jenë të aftë për punë nga ana shëndetësore;
- 5) Të mos jenë të dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- 6) Të mos ketë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimi.

### **Kritere të veçanta**

- 1) Të zotërojnë minimalisht diplomë të Shkollës së Mesme;
- 2) Të njohin legjislacionin në fuqi, preferohet atë në mjedis;
- 3) Të kenë njohuri të mira në përdorimin e kompjuterit;
- 4) Të njohin një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze;
- 5) Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe etikë profesionale

## DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a. Kërkesë me shkrim;
- b. Jetëshkrim i aplikantit;
- c. Fotokopje të diplomës/diplomave dhe listës së notave të noterizuar;
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Dëshmi penaliteti
- f. Raport Mjekësor për aftësinë në punë
- g. Fotokopje të librezës së punës
- gj. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në protokollin e Zyrës së Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”, brenda datës 04/03/2026.

## REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Komisioni Ad-Hoc do të shpallë në faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit [www.mjedisi.gov.al](http://www.mjedisi.gov.al), tek kategoria/menuja “Njoftimet”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për intervistën e strukturuar me gojë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e mos kualifikimit.

## FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

**Kandidatët do të intervistohen për njohuritë mbi dokumentet e listuara më poshtë:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën mbi respektimin e rregullave për përdorimin e parkut, duke përfshirë parandalimin e aktiviteteve të paligjshme dhe menaxhimin e burimeve natyrore;
- b- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre.

#### **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE KOMUNIKIMI**

**Kandidatët do të vlerësohen me pikë si më poshtë:**

- a- Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 60 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 40 pikë.

Bazuar aplikimit, sqarojmë se vetëm kandidatët të cilët do të plotësojnë kushtet për kualifikim, do të njoftohen për të marrë pjesë në intervistë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia përgjegjëse pranë ZAPK Vjosa do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesit në faqen zyrtare të ministrisë.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentacioneve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës 04.03.2026 në protokollin e ZAPK Vjosa;

Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datën 12.03.2026, në ambientet e Zyrës së Administrimit të Parkut “Lumi i Vjosës”.

**DREJTOR ZAPK VJOSA**

**Eduina GUGA**

